

NDRYSHIMET NË STRUKTURËN FAMILJARE PAS LUFTËS NË KOSOVË

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË SOCIOLOGJI

NGA

BLERINA HISENAJ



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË
PRISHTINË

SHTATOR 2021

Rezyme e temës

Ndryshimet në strukturën familjare pas luftës në Kosovë

Nga

Blerina Hisenaj

Mentori: Prof. Dr. Ardian Gola

Ky punim është i fokusuar në ndryshimet që po përjeton familja jonë kosovare viteve të fundit. Ndryshimet dhe zhvillimet sociale që sot po ndodhin në mbarë botën kanë prekur edhe strukturën e familjes. E një ndryshimi të tillë nuk i ka rezistuar as familja shqiptare. Tek ne në Kosovë ndryshimet familjare kanë filluar të vërehen më shumë qysh pas përfundimit të luftës së fundit (1998 – 1999). Çdo herë pas luftës shoqëritë pësojnë ndryshime në strukturën e tyre, e në përgjithësi në organizimin e familjes. E këtë fat e kishte edhe shoqëria kosovare. Siç dihet familja shqiptare historikisht ishte tradicionale, patriarkale, ku e gjithë jeta familjare organizohej sipas të drejtës zakonore. Ku këto ligje mbijetuan për shekuj të tërë. Kurse gjatë viteve të fundit familja shqiptarë është dukë kaluar një fazë tranzicioni, e cila është duke ja ndryshuar “fytyrën”, familjes tradicionale e që është duke krijuar një model të ri të familjes atë moderne, e cila nuk ngjason pothuajse në asgjë me vitet më përpara.

Ne pjesën kryesore të këtij punimi kam elaboruar disa nga ndryshimet që po ndodhin tek familja jonë, dukë i veçuar edhe disa nga faktorët të cilët kanë ndikuar tek këto ndryshime. Siç janë: familja ka ndryshuar nga familja e madhe në familje të vogël, është ngritur numri I të punësuarve dhe shkalla e arsimimit, e sidomos ka evoluar pozita e femrës, po behet planifikimi familjar, gjithashtu ka evoluar edhe forma e martesës etj.

Mirëpo këto ndryshime nuk kanë ndodhur në çdo familje në të njëjtën kohë. Diku ato pranohen më shpejt e diku më ngadalë. Varet nga faktorët e jashtëm si vendbanimi, niveli I shkollimit të anëtareve të familjes, shkalla e punësimit, standardi jetësor etj.

Një çështje e shtjelluar në këtë punim është edhe emancipimi i femrës në Kosovë. Femra ishte dhe mbetet si shtylla kryesore e shoqërisë qofte në një sistem shoqëror të zhvilluar apo të pazhvilluar. Andaj emancipimi I sajë është një proces I domosdoshëm jo vetëm për të mirën e saj

por edhe të tërë shoqërisë. Zhvillimi dhe emancipimi I gruas në shoqërinë e sotme moderne I jepe asaj një imazh, atij shteti së në cilën shkallë të kulturës është ai popull apo komb. Edhe pse kjo lufte është zor e arritshme e sidomos ne vendet qe ende janë nën ndikimin e vetëdijes tradicionale, e që Kosova është një trevë e tillë. Por kohëve të fundit shihet disa të arritura pozitive në këtë drejtim. Mirëpo edhe pse ka përmirësime të kënaqshme, ende tek ne gjenden rrënjët e patriarkalizmit.

Çështje tjetër e trajtuar është edhe evoluimi i martesës. Shoqëria jone, me heret ishte e njohur për numër të madh të martesave si dhe martesë të hershme. Kurse sot kemi zbehje të këtyre zakoneve dhe në bazë të statistika ka rënje të numrit të martesave dhe shtyrje të moshës së hyrjes në martesë nga të dy gjinitë. Dalja jashtë suazave shtëpiake, shkollim, punësimi etj., u ka dhënë mundësi të rinjve që të vendosin vet për fatin e jetës së tyre, duke bërë kështu që edhe martesë të humb vlerën që kishte më herët.

Në vazhdim të këtij punimi kam trajtuar edhe disa nga faktorët negativ, të cilët i ka sjellë ky tranzicion familjar. Pra përveç aneve pozitive kjo kthesë tranzicioni ka sjellë edhe disa problemë më të cilat po ballafaqohet sot familja jone kosovare. Si një nga sfidat më seriozë që po e rrezikon familjen janë problemet e shfaqura të martesës. Në të njëjtën kohë kemi një rritje të numrit të divorceve, në krahasim më periudhën e paraluftës dhe në raport më numrin e përgjithshëm të popullsisë së Kosovës, të cilat po e përmbysin familjen. Gjithashtu vërehet se ka rritje të rasteve të dhunës në familje. Nga viti në vite është duke rënë numri I lindjeve në vend, ku qiftet e reja nuk po preferojnë të lindin shumë fëmijë. E po ashtu edhe probleme të tjera siç është mos respektimi i prindërve nga fëmijët, problemet dhe konfliktet e ndryshme brenda familjes si rezultat I shkaqeve socio – ekonomike dhe shkaqeve të tjera, etj.

Në fund të punimit janë të dhënat statistikore të nxjerrura nga hulumtimi në teren. Ku si procedurë hulumtuese është përdorur anketimi i cili është realizuar në formën e pyetësorit.

Si përfundim mund të themi se sot familja jonë po përballet mes tradicionales dhe asaj modernes. Kjo për faktin së ajo e vjetra tradicionale është dëmtuar por nuk është zhdukur akoma në tersi, kurse e reja modernia nuk është formuar akoma plotësisht.